MIGRACIONI DHE DIASPORA

Bashkia Has

Hyrje

Bashkia Has, me qendër në qytetin e Krumës, është një nga bashkitë më të vogla në veri të Shqipërisë dhe pjesë e Qarkut Kukës. Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia numëron 11,684 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, popullsia arrin në 21,764 banorë, ku rreth 7,554 janë të grupmoshës 15–65 vjeç.

Hasi është një ndër zonat që historikisht ka përjetuar nivele të larta migracioni, si të brendshëm ashtu edhe ndërkombëtar. Megjithëse të dhënat statistikore të detajuara mbi migracionin dhe diasporën në nivel vendor mbeten të kufizuara, fenomeni i emigracionit përbën një nga sfidat më të mëdha sociale dhe demografike për komunitetin hasjan.

Migracioni nga Hasi drejt vendeve të huaja është rritur ndjeshëm pas viteve ’90, pas ndryshimeve politike dhe ekonomike në vend. Destinacionet kryesore të emigrimit kanë qenë Kosova, për shkak të lidhjeve historike dhe familjare, si dhe Gjermania, Zvicra, Austria, Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar.

Në dekadën e fundit, Mbretëria e Bashkuar është kthyer në një nga destinacionet kryesore të emigrimit për qytetarët hasjanë. Sipas burimeve jozyrtare dhe të dhënave nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, vlerësohet se rreth 4,800 qytetarë me origjinë nga Hasi jetojnë aktualisht në Mbretërinë e Bashkuar.

Pas vitit 2021, emigracioni ka marrë një formë më të organizuar dhe më të zgjeruar drejt vendeve të Bashkimit Evropian, veçanërisht drejt Gjermanisë dhe Italisë. Fenomeni i emigracionit mbetet shumë i theksuar në territorin e Bashkisë Has, ku pothuajse çdo familje ka të paktën një anëtar që jeton ose punon jashtë vendit. Në shumë raste, deri në 80% e anëtarëve të familjeve kanë emigruar.

Të dhënat tregojnë se mbi 30–40% e të rinjve të grupmoshës 18–35 vjeç kanë emigruar gjatë pesë viteve të fundit. Ky trend ka ndikuar drejtpërdrejt në tkurrjen e popullsisë aktive, plakjen demografike dhe dobësimin e strukturës sociale dhe ekonomike të zonës.

Pavarësisht potencialeve natyrore, trashëgimisë kulturore dhe vlerave arkitekturore që karakterizojnë Hasin, emigracioni i vazhdueshëm ka sjellë pasoja të dukshme në zhvillimin lokal dhe kohezionin social.

Në këtë kontekst, Bashkia Has ka ndërmarrë hapa konkretë për të krijuar një qasje të strukturuar dhe afatgjatë për menaxhimin e migracionit dhe forcimin e lidhjeve me diasporën, përmes hartimit dhe zbatimit të Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën, si dhe ngritjes dhe forcimit të strukturave përkatëse.

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën është krijimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së nevojshme për qeverisjen efektive, koordinimin ndërinstitucional dhe orientimin e duhur të diasporës dhe migracionit, duke i kthyer ato në faktorë të rëndësishëm të zhvillimit social dhe ekonomik vendor.

Plani synon gjithashtu:

- Forcimin e lidhjeve ndërmjet diasporës dhe vendit të origjinës;
- Nxitjen e përfshirjes aktive të diasporës në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit;
- Garantimin e mundësive të barabarta për qytetarët, pavarësisht vendndodhjes së tyre;
- Promovimin e gjithëpërfshirjes sociale dhe integrimit me të drejta të plota;
- Forcimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Për realizimin e këtyre objektivave, Bashkia Has synon përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të burimeve vendore, forcimin e planifikimit strategjik dhe ngritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore.

Standardet që Udhëheqin Punën e Punonjësve të Bashkisë

Punonjësit e Bashkisë Has, të cilët janë në vijën e parë të bashkëveprimit me migrantët dhe diasporën, luajnë një rol thelbësor në garantimin e shërbimeve cilësore dhe në forcimin e besimit institucional.

Në ushtrimin e detyrës së tyre, punonjësit angazhohen të respektojnë standardet e mëposhtme:

1. Sjellje profesionale dhe e paanshme

Punonjësit duhet të mbajnë një qëndrim profesional, etik, jo-politik dhe të qasshëm në çdo bashkëveprim me qytetarët.

2. Ofrimi i informacionit të saktë

Informacioni dhe shërbimet duhet të jenë të sakta, të kuptueshme dhe të përshtatura sipas nevojave të individëve.

3. Ndërtimi i besimit dhe respektit

Çdo individ duhet të trajtohet me respekt, dinjitet dhe mirëkuptim.

4. Komunikim efektiv

Punonjësit duhet të sigurojnë komunikim aktiv dhe të qartë, duke ofruar orientim dhe referime të përshtatshme.

5. Përmirësim i vazhdueshëm profesional

Stafi duhet të përditësojë njohuritë dhe praktikat profesionale në mënyrë të vazhdueshme.

6. Konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave

Të gjitha informacionet personale duhet të trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Informim dhe orientim për diasporën

Punonjësit ofrojnë informacion, orientim dhe referim për shërbime të ndryshme në nivel lokal dhe kombëtar.

8. Koordinimi me palët e interesuara

Bashkia bashkëpunon me institucione publike, organizata jofitimprurëse dhe aktorë të sektorit privat për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse për migrantët dhe diasporën.

Punonjësit e bashkisë shërbejnë gjithashtu si pika fokale për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve, si dhe për referimin e nevojave dhe kërkesave tek institucionet kompetente.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në Fushën e Migracionit dhe Diasporës

Në përputhje me ndryshimet në legjislacionin për vetëqeverisjen vendore, bashkive u janë ngarkuar përgjegjësi të rëndësishme në lidhje me migracionin dhe diasporën.

Një nga detyrat kryesore është krijimi i strukturave të posaçme për migracionin dhe diasporën, me qëllim adresimin në mënyrë efikase të nevojave të migrantëve dhe anëtarëve të diasporës.

Këto struktura kanë për detyrë:

- Ofrimin e informacionit dhe orientimit për proceset e migracionit dhe riintegrimit;

- Koordinimin me ministritë dhe institucionet përgjegjëse;
- Bashkëpunimin me ambasadat dhe konsullatat shqiptare jashtë vendit;
- Sigurimin e qasjes së migrantëve në shërbime sociale dhe mbështetëse;
- Nxitjen e përfshirjes së diasporës në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor lokal.

Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi mikpritës dhe gjithëpërfshirës për diasporën, duke promovuar kontributin e saj në zhvillimin vendor përmes iniciativave dhe partneriteteve të ndryshme.

Veprimtaritë e Bashkisë Has në Fushën e Migracionit dhe Diasporës

Bashkia Has është angazhuar në mënyrë aktive në fushën e migracionit dhe diasporës përmes hartimit dhe zbatimit të Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën.

Në kuadër të këtij angazhimi janë zhvilluar:

- Aktivitete informuese dhe forume lokale me përfaqësues të diasporës;
- Iniciativa për përfshirjen e të rinjve dhe familjeve migrante;
- Bashkëpunime me institucione dhe partnerë vendas dhe ndërkombëtarë;
- Veprimtari për promovimin e rolit të diasporës si aktor zhvillimi.

Këto iniciativa kanë kontribuar në forcimin e lidhjeve ndërmjet diasporës hasjane dhe komunitetit lokal, si dhe në rritjen e rolit të diasporës në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të Bashkisë Has.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, komuniteti hasjan ka përfituar mbështetje konkrete në fusha të ndryshme, përfshirë pajisje dhe investime në sport, kulturë dhe aktivitete komunitare.

Diaspora hasjane konsiderohet një ndër diasporat më aktive, me përfshirje reale në zhvillimin lokal dhe forcimin e kohezionit social.

Bashkia Has është vlerësuar për iniciativat e saj me ndikim pozitiv në mbështetje të migrantëve, angazhimit të diasporës dhe promovimit të zhvillimit ekonomik e social.

Ky vlerësim është dhënë në kuadër të konkursit “Nismat me ndikim pozitiv në komunitet”, organizuar me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

Bashkia Has u përzgjodh ndër bashkitë fituese si rezultat i angazhimit të vazhdueshëm në hartimin dhe zbatimin me sukses të Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën, si dhe për organizimin e aktiviteteve konkrete që synojnë forcimin e lidhjeve me diasporën dhe përfshirjen e saj në zhvillimin lokal.

Ky vlerësim përfaqëson një motivim të rëndësishëm për vijimin e iniciativave në mbështetje të komunitetit dhe bashkëpunimit me diasporën.









Bashkia Has

Drejt një qeverisjeje vendore gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme